

Ky raport diskuton të gjeturat nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe avokon për zbatim sa më të efikas të tij në Kosovë.

Monitorimi i zbatimit të këtij ligji evidenton probleme të shumta duke filluar nga mungesa e Komisionerit, mungesa e legjislacionit sekondar dhe akteve të brendshme të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), mospërputhje në zbatimin e Ligjit 2019 si pasojë e operimit me legjislacion sekondar që derivon nga Ligji 2010, llogaridhënie të limituar sa i përket raportimit në Kuvend nga Komisioneri dhe institucionet tek AIP, mos-respektim të parimeve në lidhje me të dhënat e hapura nga institucionet publike, mungesa e raporteve vjetore dhe dokumenteve strategjike për vitet paraprake nga ana e institucioneve publike, sfida të vazhdueshme në qasjen e kontratave që përmbajnë shuma të mëdha parash, ndër të tjera.

Duke u bazuar në këto të gjetura dhe me qëllim të zbatimit sa më efikas të ligjit për qasje në dokumente publike, ky raport sugjeron dhe ofron arsyetime të bazuara dhe të gjera për të zbatuar rekomandimet e mëposhtme:

- Kuvendi sa më shpejtë që të jetë e mundur të bëjë emërimin e Komisionerit në mënyrë që të mundësojë funksionalizimin e AIP.
- AIP duhet të hartojë të gjitha aktet nënligjore dhe aktet e brendshme në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-081.
- AIP duhet të hartojë dhe miratojë udhëzime të qarta për institucionet publike për përmbajtjen dhe mënyrën e bërjes së testit të dëmit dhe të interesit publik në procedurën e marrjes së vendimit dhe arsyetimit të vendimeve për refuzimin e qasjes në dokumente publike në bazë të nenit 18.3 të Ligjit 2019.
- Institucionet publike duhet të respektojnë nenin 31.2 të Ligjit 2019 sa i përket raportimit. Pra, të gjitha institucionet obligohen të raportojnë në AIP në baza vjetore.